



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:231268  
Datë: 04.03.2025  
Numri i dokumentit: 06934810

PKR.nr.83/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Xhemajl JUSUFI, me praktikanten Ellmeka Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurës H.U., për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.47/2024, të datës 17.09.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 24.02.2025, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Sahit Tmava, e pandehura H.U. si dhe mbrojtësja e saj sipas detyrës zyrtare, avokate Festëbardhë Ismajli, me datë 25.02.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

H.U., nga i ati U., e ëma H., e gjinisë H., i lindur me ....., në fshatin Druar, Komuna e Vushtrrisë, tani me vendbanim në Rr. "B.M.", nr.149, me numër personal të identifikimit ....., ka kryer shkollën e mesme, pensioniste, e ve, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 02.09.2019, e pandehura H.U., në pozitën e Zyrtares së Gjendjes Civile pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë, duke shfrytëzuar pozitën apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të një dobie pasurore për vete ose tjetrin, i tejkalon kompetencat e saj, e në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile, e futë në sistemin elektronik qendror të gjendjes civile si rishkrimi i lindjes duke gjeneruar numrin

personal #1252727171 në emër të A.M. i cili nuk është i lindur në Kosovë as edhe prindërit e tij, me ç'rast i mundëson të njëjtit të pajiset me pasaportë të Republikës së Kosovës.

Me këtë ka kryer veprën penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72 dhe 216 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe neneve 242, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së, të akuzuarën e:

### G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej dy (2) viteve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Obligohet e pandehura që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr.47/2024 e datës 13.09.2024 kundër të pandehurës H.U., për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 24.02.2025 në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i shtetit Sahit Tmava, e pandehura H.U., si dhe mbrojtësja e saj sipas detyrës zyrtare, avokate Festëbardhë Ismajli.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, e pandehura ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka deklaruar se në atë kohë ka qenë shume e ngarkuar me punë në këtë veprim kanë ndikuar edhe mosha që ishte në prag të pensionit por edhe gjendja shëndetësore dhe shpreh keqardhje për atë që ka bërë, e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Ndërsa sa i përket sanksionit penal, ka mbështetur fjalën e mbrojtëses së saj dhe ka shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur, e njofton gjykatën se është në një gjendje të rënduar shëndetësore vuan nga probleme në zemër dhe mushkëri dhe merr terapi të përditshme lidhur me këto probleme, gjithashtu ka deklaruar se ka dokumentacione të cilat e vërtetojnë këtë gjendje shëndetësore, një kopje të të cilave ia dorëzoi gjykatës.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se: janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës të bëhet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës, pasi që e njëjta është këshilluar mjaftueshëm me mbrojtësin e saj dhe është njoftuar nga gjykata për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Ndërsa sa i përket sanksionit penal, i ka propozuar gjykatës të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me ligj, mirëpo pranimin e fajësisë posaçërisht ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurës H.U., avokate Festëbardhë Ismajli, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se: i propozon gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, pasi që e njëjta është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës. Sa i përket sanksionit penal, kërkon nga gjykata që të marr parasysh rrethanat lehtësuese siç parashihet në dispozitat e KPRK-së dhe atë pranimin e fajësisë, sjelljen e të pandehurës gjatë kësaj procedure penale, moshën e saj si dhe e njëjta ka probleme të mjaftueshme shëndetësore të cilat mund të aprovohen edhe përmes dokumentacionit përkatës shëndetësor, andaj ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturës së saj të shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar se e pandehura, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: formular aplikimi i të pandehuri A.M.

për pasaporte kombëtare i dt.03.09.2019, ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile E .... në emër të A.M. i dt.02.09.2019 lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Komunën e Gjakovës, përgjigjen në kërkesë së Ministrisë së punëve të brendshme-Agjencia e regjistrimit civil me numër 02 protokoll .... e dt.19.09.2024, Vendimi i Drejtorisë për administratë-zyra e gjendjes civile në Komunën e Vushtrrisë me nr.... e dt.06.03.2024 për anulimin e regjistrimit të lindjes për Z. A.M. NP....., njoftimi nga Agjencia e regjistrimit civil me nr. të protokollit ...i dt.29.02.2024 në lidhje me Inspektimin e zhvilluar, Kërkesa e Drejtorisë për pajisje me dokumente për shpallje të dokumenteve të pavlefshme e dt.08.03.2024, deklarata e të pandehurës, si dhe të bëhet vështrim në dosjen kriminale në emër të të pandehurës si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se e akuzuara ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurës se pas pranimit të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurës dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se e pandehura, me veprimet e saj, ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

*Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata si rrethanë rënduese, gjeti rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale dhe kjo në kontekst të asaj që, mundësimi i pajisjes me letërnjoftim dhe pasaportë të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me ligjin, për personat të cilët nuk kanë qenë të lindur në Republikën e Kosovës, potencialisht do tu mundësonte këtyre personave, përveç se shfrytëzimin e benefiteve të cilat

rrjedhin nga të qenurit shtetas i Republikës, edhe keqpërdorimin (eventual) të këtyre të drejtave dhe benefiteve në emër identitetit të pavërtetë të këtyre personave, si dhe faktin se e pandehura edhe më parë ka qenë e gjykuar me vendim të formës së prerë dhe atë në katër raste.

Ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga e akuzuara, kërkim faljen për veprën të cilën e ka kryer, moshën e shtyrë të pandehurës, gjendjen shëndetësore të saj pasi që e njëjta vuan nga probleme në zemër dhe mushkëri dhe për këto probleme shëndetësore, ka dorëzuar edhe dokumentacion mjekësor, rrethanat personale e familjare marrë parasysh faktin se njëjta është e ve dhe nënë e dy fëmijëve si dhe kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale e që është afërsisht gjashtë vite andaj nëse marrim parasysh edhe faktin se e pandehura tash e pesë vite është në pension, kjo përbënë një kohë relativisht të gjatë nga kryerja e veprës penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim të kushtëzuar është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Po ashtu, Gjkata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen e pandehura të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

#### *Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

#### *Kërkesa pasurore juridike:*

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata nuk ka vendosur pasi që nuk kishte palë të dëmtuar të propozuar në aktakuzë.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.83/2024, datë 03.03.2025

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari:  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.